



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058270

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05541473

KPPP.nr.17/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kompania ŠIRJAN d.o.o., me seli në Kroaci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Kërveshi & Partners” SHP.K., Shoqëri e avokatëve, me seli në rr. “B” Hyrja C15/10. Nr. 2, Mati 1, në Prishtinë, kundër debitorit Melii Farm SH.P.K., me NUI: 811865841, me seli në Sallabajë, Podujevë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr.769/22 të datës 06.12.2022, nga Përmbareuesi Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 03.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Melii Farm SH.P.K., dhe Urdhri Përmbaremore P.nr.769/22, i datës 06.12.2022, i Përmbareuesit Privat Ilir Mulhaxha, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit nga i autorizuari i kreditorit Kompania ŠIRJAN d.o.o., me datë 06.12.2022, ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr.769/22, me të cilin e ka lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 482/P1/1 të datës 29.12.2021 dhe CMR me Nr. C 1946995, t’ia paguaj kreditorit shumë prej 33,200.00 €, me kamatë vjetore prej 8%, duke llogaritur nga data kur fatura është bërë e arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e kësaj procedurës përmbaremore, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të urdhrin, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen përmes

zbatimit të përbarimit sipas llogarive bankare të debitorit pranë bankave komerciale të licencuara në Kosovë dhe bartjen në llogarinë e veçantë bankare të përbaruesit privat Ilir Mulhaxha, ose me shënimin e përbarimit, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit dhe nga shitja e realizuar të përmbushet dhe borxhi i debitorit ndaj kreditorit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore së bashku me tarifën e efikasitetit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit Valmir Zhjeqi, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor duke theksuar ndër të tjerash se fatura mbi bazën e të cilës është lëshuar ky urdhër nuk i përmbush kushtet e dokumentit të besueshëm, për arsye se në rastin konkret fatura nuk është e pranuar dhe as e vulosur nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përbarimor, si dhe të urdhërohet kreditori që t'ia paguaj debitorit të gjitha shpenzimet e procedurës dhe atë në shumën prej 416.00 € për përpilimin e prapësimit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar se dokumenti i besueshëm në bazë të cilit është inicuar procedura përbarimore i përmbush të gjitha kushtet e parapara ligjore. Ka shtuar se në këtë dokument është treguar kreditori dhe debitori, është treguar objekti, është treguar lloji si dhe është treguar shuma. Ka deklaruar në rastin konkret fatura është pranuar nga debitori dhe se kjo faturë e mban titullin “CMR” e cila përbën dokument të njohur botërisht dhe të pakontestueshëm, si dhe e njëjta është nënshkruar dhe vulosur nga debitori. Në lidhje me pretendimet e debitorit se nuk ka bërë blerjen nga kreditori dhe se nuk ka pranuar një faturë të tillë, e njëjta nuk qëndron, sepse nga provat materiale të ofruara vërtetohet se debitori ka pranuar sasinë prej 16600,00 kg të mallit mish viçi për therje, e që vërtetohet nga dokumenti zyrtar CMR, gjithashtu kreditori ka bashkëngjitur edhe provat materiale si “Certifikata e qarkullimit të mallrave Nr. O 1272356 të datës 29.12.2021” dhe “Dokumenti shoqërues i eksportit i datës 29.12.2021”. Gjykatës i ka propozuar prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, si dhe të obligohet kreditori që përveç shpenzimeve të theksuara në propozimin për përbarim, t'ia paguaj edhe shpenzimet për përgjigje në prapësim në vlerë 416.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu

referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par.3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr. 482/P1/1 të datës 29.12.2021 dhe CMR me Nr. C 1946995, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori pasi që e njëjta nuk është nënshkruar ose vulosur nga ana e debitorit dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbartim.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt fatura e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe CMR-të, si dokumente ndërkombëtare për mënyrën e transportit të mallrave, të cilat janë të nënshkruara dhe vulosura nga debitori, mirëpo gjeti se dokumentet mbi transportimin e mallrave (CMR) paraqesin dëshmi në raport ekzistimin e kontratës mbi transportimin e mallrave mes dërguesit dhe transportuesit, këtu kreditorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia e detyrimit monetar që buron nga fatura. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se procedura përmbartimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit

është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.17/23, datë 02.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.